

URDHËR
Nr. 393, datë 3.6.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për nënshkrimin e autorizimit të prodhimit të barnave në Republikën e Shqipërisë, te znj. Eugena Tomini, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj. Eugena Tomini, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala